



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**KPM-2017/05**

Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore dhe duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 2, pika 6 dhe 11, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR RENDITJEN LOGJIKE TË KANALEVE**

### **NENI 1 QËLLIMI**

Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për renditjen e kanaleve televizive në operatorin e multipleksit, me qëllim të sigurimit të qasjes më të lehtë për publikun në programet me përmbajtjet gjeneralistike dhe në kategoritë e veçanta të përmbajtjeve programore të ofruara nga ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale.

### **NENI 2 FUSHËVEPRIMI**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen ndaj të gjithë të Licencuarve të cilët operojnë si operatorë të multipleksit.

### **NENI 3 PËRKUFIZIMET**

1. **Renditja Logjike e Kanaleve RLK (Logical Channel Numbering – LCN)** – renditja automatike e kanaleve sipas kategorive të programeve të përcaktuara me këtë Rregullore.
2. **Bartja e detyrueshme** – obligimi për bartje të detyrueshme të ofruesve të shërbimeve mediale nga operatorët e multipleksëve.
3. **Operatori i MUX-it** – personi juridik që ofron infrastrukturën teknike për shpërndarjen tokësore të programeve dixhitale dhe shërbimet suplementare për transmetimin dixhital të të dhënave.

4. **Multipleksi** –një set i standardizuar i sinjaleve dixhitale, i shprehur në Mbit/s (Mega-bit-për-sekondë), që përmban disa programe televizive dhe/ose të radios dhe/ose të dhëna të tjera, të cilat transmetohen dhe emetohen në të njëjtën kohë dhe në mënyrë të thurur.
5. **Ofruesi i shërbimeve mediale (OSHM)** - personi fizik apo juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes së programeve audio apo audio-vizuale të shërbimit medial audiovizual dhe i cili përcakton mënyrën se si ato do të organizohen;
6. **Kanal gjeneralistik** – ofruesi i shërbimit medial audiovizual që ofron një gamë të gjerë të programeve dhe llojeve të programeve për publikun e ndryshëm.
7. **Kanal tematik** – ofruesi i shërbimit medial audiovizual, programi i të cilit përmban 70% të një lloji të caktuar programor, si informativ, edukativ, argëtues, për fëmijë, sportiv, shkencor etj.
8. **Licencë** – leja e dhënë nga KPM-ja për operatorin e multipleksit për të ushtruar aktivitet transmetimi në Republikën e Kosovës;
9. **I Licencuar** - personi juridik i licencuar nga KPM për të vepruar si operator i multipleksit.

#### NENI 4 RENDITJA LOGJIKE E KANALEVE NË MULTIPLEKS

1. Me qëllim të sigurimit të qasjes sa më të lehtë të publikut në ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale që ofrojnë përmbajtje programore gjeneralistike, dhe kategori të veçanta të përmbajtjeve programore në interesin e përgjithshëm të publikut, operatori i MUX-it obligohet që të bëjë renditjen logjike të kanaleve televizive.
2. I Licencuari si operator i MUX-it obligohet që të bëjë renditjen e kanaleve televizive sipas kritereve të përcaktuara me këtë Rregullore.
3. Operatori i MUX-it obligohet që në qendrën e tij të operimit (Head-end) të vendosë funksionin e RLK-së.
4. Operatori i MUX-it obligohet që të bëjë renditjen e dy kanaleve televizive të transmetuesit publik (RTK 1 dhe RTK 2) në fillim të listës së kanaleve, përmes sistemit të RLK-së.
5. Pas kanaleve të transmetuesit publik, operatori i MUX-it në nivel shtetëror obligohet që të bëjë renditjen e dy kanaleve nacionale komerciale me transmetim tokësorë analog, si dhe kanalet tjera që do t'i përcaktojë KPM-ja.
6. Operatori i MUX-it në nivel regjional dhe në nënzonën Prishtina obligohet që të bëjë renditjen e kanaleve regjionale komerciale në zonën e mbulimit sipas kritereve të përcaktuara me këtë Rregullore.



7. Ndërlidhja e grupimeve të kanaleve në mes MUX-ve shtetëror, regional dhe atë të nënzonës Prishtina do të përcaktohet me listë të veçantë nga KPM.

#### **NENI 5**

#### **KRITERET PËR RENDITJEN LOGJIKE TË KANALEVE TELEVIZIVE**

1. Operatori i MUX-it obligohet që krahas kanaleve të transmetuesit publik të bëjë renditjen e kanaleve komerciale të definuara me Ligjin për Dixhitalizim dhe kanaleve tjera të cilat ofrojnë programe me përmbajtje gjeneralistike dhe tematike, që do të përcaktohen nga KPM-ja.
2. KPM, bazuar në përcaktimet ligjore dhe kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore, do të vendosë për renditjen logjike të kanaleve televizive që do të transmetohen në operatorët respektiv të multipleksëve.
3. Për kanalet me përmbajtje gjeneralistike kriter për renditjen logjike të tyre do të jetë niveli i sasisë së programit të shërbimit publik (program vetanak/të bashkëprodhuar apo të produksioneve vendore) sipas përqindjes më të lartë.
4. Për kanalet tematike, kriter për përparësi në renditjen logjike të tyre do të jetë lloji i programit, sipas ndarjes në vijim:
  - a) Programet informative;
  - b) Programet për fëmijë;
  - c) Programe dokumentarë;
  - d) Programe argëtuese si filma, seriale, muzikë, sport etj.
5. KPM mund të ndryshojë vendimin për renditjen logjike të kanaleve të transmetuara nga operatorët e MUX-it në bazë të politikave strategjike dhe kërkesave të interesit publik.

#### **NENI 6**

#### **KUFIZIMET PËR NDRYSHIM TË RENDITJES LOGJIKE TË KANALEVE**

1. Operatori i MUX-it nuk mund të bëjë ndryshimin e renditjes logjike të kanaleve në MUX pa aprovim paraprak nga KPM.
2. Operatori i MUX-it nuk mund të bëjë ndryshimin e kategorisë së kanaleve, duke bërë bartjen e një kanali nga një kategori në një tjetër pa aprovim paraprak nga KPM.

**NENI 7**  
**RAPORTIMI DHE INSPEKTIMI**

1. Operatori i MUX-it duhet të raportojë në KPM lidhur me aspektet e punës që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj Rregullore.
2. Me qëllim të vlerësimit të zbatueshmërisë së kësaj Rregulloreje, operatori i MUX-it obligohet t'i lejojë qasje KPM-së për aspekte të veçanta të punës së tij.
3. Operatori i MUX-it obligohet që të njoftojë me shkrim KPM-në lidhur me renditjen logjike të kanaleve sipas listës së ofruar nga KPM.

**NENI 8**  
**SANKSIONET**

Për shkelje të kësaj Rregulloreje KPM do të ndërmarrë masa ligjore në pajtim me Ligjin e KPM-së Nr. 04/L-44 dhe Ligjin për Dixhitalizim Nr. 05/L-027.

**NENI 9**  
**HYRJA NË FUQI**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



**Adnan MEROVCI**  
**Kryetar**  
**Komisioni i Pavarur i Mediave**



25.01.2017  
**Data**